

I. Organizata "QATAR CHARITY" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson drejtori i saj **z. Mahmoud Abbas Shaker** (pala e parë) dhe:

II. Komuna e Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson kryetari **z. Xhafer Tahiri**, tutje referuar si pala e dytë.

Me datën 23 / 04 / 2020, lidhën këtë :

Memorandum Bashkpunimi

Neni 1.

Objekt i këtij memorandumi është realizimi i projektit "PAKOJA E RAMAZANIT", projekti ka për qëllim përkrahjen me 200 pako ushqimore si dhe me 5000 kg Miell për 200 familje përfituese nga Komuna e Vushtrrisë .(Një familje përfiton një pako ushqimore dhe 25 kg miell). Një pako posedon këta artikuj ushqimor: 6 litra vaj, 3 qese oriz, 5 kg sheqer, 5 qese makarona, 6 qese fasule, 0.50 kg çaj, dedikuar familjeve me gjendje të rënd ekonomike, shuma e një pakoje ushqimore ka vlerën **41 €**, ndërsa në total projekti ka vlerën e **8200 €**.

Neni 2.

Pala e parë Organizata "QATAR CHARITY" merr përsipër të gjitha shpenzimet e realizimit të këtij projekti.

Neni 3.

Nga pala e dytë, kërkohet që të sjellin listën e të propozuarve për 200 familje të propozuara me kushte të rënda ekonomike, Në listë duhet të jenë të gjitha të dhënat e kërkuara nga pala e parë.

Lista e përfituesve duhet të ndahet në bazë të lokacioneve dhe ti ipet secilit përgjegjës për shpërndarjen e pakove në atë lokacion, ne menyrë qe realizimi i projektit te jetë më i lehtë.

Neni 4.

Pala e dytë ka për obligim që përfituesit ti përzgjedhë në së paku 5 lokacione të përafërta si dhe të siguroj transportin e pakove nga vëndpranimi në qytetin e Vushtrrisë deri në lokacionet e caktuara, pala e dytë gjithashtu duhet të siguroj edhe staf të mjaftueshëm teknik për shpërndarjen e pakove ushqimore.

Neni 5.

Gjatë shpërndarjes se pakove në secilin grup për shpërndarjen e pakove do jetë edhe një punëtor i Qatar Charity për monitorimin e aktivitetit.

Neni 6.

Palët nënshkruese pajtohen që në rast të ndonjë paqartësie eventuale në mes palëve nënshkruese sa i përket realizimit të projektit sipas këtij Memorandumi, zgjidhja të bëhet me mirëbesim dhe biseda të ndërsjella mes tyre.

Neni 7.

Ky memorandum është i lidhur në dy (2) kopje identike, prej të cilëve secila palë mban nga një (1) kopje.

Nënshkruajnë:

Drejtor i organizatës "Qatar Charity"

z. Mahmoud Abbas Shaker



Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

z. Xhafer Tahiri

